



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
MINISTRI

URDHËR

Nr. 220, datë 17.07.2020

PËR MIRATIMIN E FORMULARIT TË ANKESAVE PËR PËRMBARUESIT  
GJYQËSORË PRIVATË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të nenit 62, të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarrimor gjyqësor privat”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e formularit të ankesave për përmbarruesit gjyqësorë privatë, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Formulari i ankesës publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë, si dhe Sektori i Arkiv-Protokollit pranë Ministrisë së Drejtësisë, të marrin masat e nevojshme për ndjekjen, zbatimin dhe njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

ETILDA GJONAJ (SALIU)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .20\_\_

FORMULARI I ANKESËS PËR PËRMBARUESIT GJYQËSORË PRIVATË

TË DHËNA MBI ANKUESIN

(Emër, mbiemër, nënshkrim)

\_\_\_\_\_

(Adresa e vendbanimit)

\_\_\_\_\_

Adresa për korrespondencë (nëse është e ndryshme nga më sipër):

\_\_\_\_\_

(Opsionale) Adresa elektronike për korrespondencë në rast se kërkuesi/ankuesi shpreh pëlqimin për mënyrën e njoftimit elektronik:

\_\_\_\_\_

Unë kërkuesi/ankuesi bie dakord që të njoftohem në adresën e mësipërme elektronike për vendimmarrjen e ministrit.

(Nr. i dokumentit të identifikimit)

\_\_\_\_\_

Kontaktet (numër telefoni): \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Kërkesë/ ankesë (specifiko duke qarkuar të saktën)

TË DHËNA MBI ZYRËN PËRMBARIMORE/PËRMBARUESIN GJYQËSOR PRIVAT PËR  
TË CILIN PARASHTRONI ANKESËN/KËRKESËN TUAJ

(Emër, mbiemër/ emërtimi i zyrës përmbarimore/përmbaruesit gjyqësor privat)

TË DHËNA MBI OBJEKTIN E ANKESËS

Specifikoni këtu:

- Objektin e ankesës suaj dhe përpikuni që në përmbajtjen e saj të jepni informacion të saktë për sa i përket problematikës që ju parashtroni, në mënyrë që, nga ana e strukturave përgjegjëse të Ministrisë së Drejtësisë të vijohet me trajtimin dhe verifikimin e saj; dhe/ose
- Të dhëna mbi veprimin ose mosveprimin konkret të përmbaruesit gjyqësor privat për të cilin ankoheni; dhe/ose
- Të dhëna mbi veprimin e gjykatës, urdhrin e ekzekutimit për të cilin referoni; dhe/ose
- Referoni nëse e keni ankimuar këtë veprim në gjykatë nën frymën e parashikimeve të nenit 610, të Kodit të Procedurës Civile, dhe/ose cilësinë tuaj në çështjen të cilën ka ekzekutim ky përmbarues, dhe/ose,

A keni paraqitur ndonjë kërkesë të njëjtë apo të ngjashme pranë ndonjë institucioni shtetëror lidhur me të njëjtën çështje? Nëse PO, specifikoni më poshtë institucionin dhe statusin e shqyrtimit të kërkesës/ankesës suaj në të dhe në rast se keni dokumentacion provues, bashkëngjiteni atë:

---

---

## DEKLARIME

Deklaroj se i gjithë informacioni që kam vënë në dispozicion, përmes kësaj ankese/kërkese është i vërtetë dhe i saktë.

## KONFIDENCIALITETI

Në rast se kërkoni ruajtjen e konfidencialitetit, bazuar në pikën 3, të nenit 62, të ligjit nr. 26/2019, qarko më poshtë:

Po



Jo



## LISTA E DOKUMENTEVE

Kjo kërkesë/ankesë shoqërohet nga dokumentet si më poshtë:

---

---

---

---

---

---

Nënshkrimi i kërkuesit/ankuesit

(emër, mbiemër, nënshkrim)

*Në vijim ju bëjmë me dije se do të konfirmojmë marrjen e ankesës suaj brenda 30 ditëve. Pas administrimit të saj dhe kryerjes së verifikimeve përkatës, nga ana e strukturave përgjegjëse të Ministrisë së Drejtësisë, do të njoftoheni mbi vendimin për arkivimin e ankesës, për fillimin e hetimit, shtimin ose ndryshimin e objektit të tij, si dhe mbylljen e hetimit, brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit përkatës.*